



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA	
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Zyra për Propozime dhe Parashirura-Kancelarija za Pradloge i Predstavke-Table Office	
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	05/2676/10-1367
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	
Data Datum Date	25.10.2016
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli,

E nderuara Kryesi e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dje me datë 24 tetor 2016 Gjykata e Apelit- EULEX, e ka konfirmuar një dënim të padrejtë të një procesi gjyqësor që kishte nisur në maj të 2013, lidhur me këtë Unë Fadil Demaku, jap dorëheqje nga pozita e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast dëshiroj t'i falënderoj votuesit e mi, për besimin që ma dhanë me votën e tyre për të qenë deputet në Kuvendin e Kosovës në dy mandate.

Besimi që kishin qytetarët në mua ka më shumë vlerë se sa proceset e montuara gjyqësore.

Njëkohësisht garantoj gjithë qytetarët e vendit tim se me veprimet e mia në kuadër të kapaciteteve dhe kompetencave që kam pasur, kam kontribuar në të mirë të këtij vendi.

Ndërsa për rastin në fjalë lë të mbetet në ndërgjegjen e atyre që kinse në emër të popullit vepruan ndryshe.

Koha do të jetë dëshmitar i pathyeshëm i veprimeve të çdonjërit prej neve.

Andaj premtoj se do të vazhdoj të punoj dhe do të angazhohem për të mirën e Republikës së Kosovës, pa marre parasysh vendin dhe pozitën ku do gjendem.

Po ashtu do të vazhdoj të jem i përgjegjshëm ndaj institucioneve të vendit tim. Do ti respektoj vendimet e tyre edhe pse në këtë rast ishin krejtësisht të padrejta.

Gjaku i dëshmorëve, i derdhur për këtë vend, gjymtyrët e humbura të invalidëve të luftës, lufta e veteranëve, sakrificat e një populli të tërë do të jenë vlera të këtij vendi deshën apo nuk deshën disa në këtë kohë.

Do të jem mirënjohës dhe falënderues ndihmës së madhe të aleatëve tanë, SHBA-ve, Gjermanisë, Francës, Anglisë dhe të gjithë atyre që na ndihmuan në përpjekjen tonë për të pasur shtet, që të jete të paktën SHTET për të mirën e gjeneratave të reja.

Me respekt,

Fadil Demaku

Prishtinë, 25 tetor 2016